



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë**

*Dokument parlamentar*

Tiranë, 26 Gusht 2016

**RAPORT  
PER PROJEKTLIGJIN  
“PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**I. HYRJE**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, i krijuar me vendimin nr. 96/2014, të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, bëri analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe bazuar në gjetjet e saj hartoi Dokumentin Strategjik për Objektivat e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, dhe propozoi për miratim një paketë të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese. I gjithë ky proces u realizua me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik.

Me vendimin nr.14, datë 30.07.2015, Komisioni miratoi dokumentin “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, i cili përbën të parin dokument gjerësisht të konsultuar në publik që analizon mbi baza objektive, shkencore dhe profesionale, nga pikëpamja ligjore dhe e zbatueshmërisë së ligjit, gjendjen aktuale të sistemit dhe të gjitha ato probleme që ky sistem mbart përsa i përket organizimit, funksionimit, mirëqeverisjes, efijencës dhe administrimit të tij.

Komisioni i Posaçëm, me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 miratoi dokumentin “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë” si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, dokumente të cilat kanë zbërthyer në masa konkrete objektivat strategjike të reformës në sistemin e drejtësisë, duke përcaktuar ligjet të cilat do t’i nënshtrohen ndërhyrjes nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

Krahas hartimit të shtesave dhe ndryshimeve në Kushtetutën e Republikën së Shqipërisë u përgatit edhe projektligji “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT

### 2.1 Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas Kushtetutës së RSH

Rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve është vlerësuar si një nga komponentët më të rëndësishëm të reformës në drejtësi. Duke qenë një masë e jashtëzakonshme, por shumë e nevojshme për gjendjen në të cilën është sistemi i drejtësisë, bazuar në rekomandimin e Komisionit të Venecias, aspektet më të rëndësishme të këtij procesi janë rregulluar në Kushtetutën e RSH (neni 179/b) dhe në Aneksin “Rivlerësim Kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, pra si pjesë e ligjit 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar””.

Gjithashtu, për shkak të rëndësisë të veçantë dhe ndikimit që ka ky komponent në reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, me rekomandim të Komisionit të Venecias, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi vendosi që bazat dhe parimet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkalla e kufizimit të pjesshëm të drejtave kushtetuese, organizimi, funksionimi i institucioneve të rivlerësimit dhe zgjedhja e tyre të bëhej në Kushtetutë.

Me 22 Korrik 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me votim unanim të të gjithë deputetëve të tij Aneksin “Rivlerësim Kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” si pjesë të ligjit 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.” Në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në Aneksin Kushtetues përcaktohen:

- Qëllimi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH (neni 179/b, paragrafi 1);
- Parimet bazë mbi të cilat do të kryhet procesi i rivlerësimit (neni 179/b, paragrafi 2);
- Subjektet që do të nënshtrohen rivlerësimit (neni 179/b, paragrafi 3 dhe 4);
- Institucionet që do të kryejnë rivlerësimin dhe organet që do të shqyrtojnë ankimimet në këtë proces, statusi i tyre si organe të pavaruara dhe të paanshme, mandati dhe kohëzgjatja e tij (neni 179/b, paragrafi 5, 6 dhe 8);
- Përfundimet e rivlerësimit dhe ndikimi i tyre në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve (neni 179/b, paragrafi 7)

Në ANEKS-in e Kushtetutës së RSH përcaktohen në mënyrë të detajuar korniza ligjore, institucionale dhe përmbajtja e procesit të rivlerësimit. Konkretisht:

- Lista e të drejtave kushtetuese që kufizohen pjesërisht në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës dhe kohëzgjatja e kufizimit (neni A);
- Roli i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në mbështetje të procesit të rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikqyrjes së gjithë procesit (neni B);
- Dispozitat e përgjithshme për Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit dhe Kolegjin e Apelit, komisionerët publikë, kushtet dhe kriteret ligjore të zgjedhjes, procedurat e zgjedhjes, votimit, rastet e papajtueshmërisë dhe ndalimit të zgjedhjes, roli i institucioneve të përfshira në këtë proces (neni C);
- Komponentët e rivlerësimit: kontrolli i pasurisë, i figurës dhe aftësive profesionale, parimet bazë të këtij procesi dhe elementët bazë mbi të cilat vlerësohen tre komponentët si dhe pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara (neni Ç, paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenet D, DH, E);

- Bashkëpunimi me institucionet shtetërore të RSH dhe detyrimi i tyre për të ofruar informacionin dhe siguruar akses të drejtëpërdrejtë në të dhënat (neni Ç, paragrafi 3);
- Mjetet e kërkimit të provave në procesin e rivlerësimit (neni Ç, paragrafi 4);
- Barra e provës e cila i kalon subjektit, si rast përjashtim dhe vetëm për këtë proces (neni Ç, paragrafi 5);
- Masat disiplinore që mund të zbatohen në këtë proces (neni Ë);
- Ankimimi dhe parimet e tij (neni F).

Sa më sipër, rezulton se Kushtetuta dhe në veçanti, ANEKS-i i saj është korniza bazë mbi të cilin projektligji detajon rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe se përmbajtja e këtij projektligji duhet të analizohet duke mbajtur parasysh përcaktimet kushtetuese dhe në veçanti, të ankesit të saj.

## **2.2 Nevoja e një ligji të posaçëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve**

Parimet bazë të organizimit të rivlerësimit, krijimi i institucioneve të rivlerësimit, kriteret, transparenca për publikun janë të parashikuara në Aneksin e Kushtetutës. Megjithatë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar nuk mund të parashikojë procedura të detajuara të rivlerësimit, pasi një gjë e tillë nuk është tipike në teknikën legjislativë të shkrimit të Kushtetutave. Për këtë arsye, neni 179/b, paragrafi 10 i Kushtetutës së RSH, i ndryshuar parashikon që procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit. Pra, krahas rregulimeve të shumta që parashikon aneksi, është e nevojshme detajimi i rregullave të tij edhe në një ligj të posaçëm.

Projektligji përcakton parimet e organizimit të procesit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe subjekteve të tjera të përcaktuara në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; metodologjinë dhe procedurat standarde të rivlerësimit; organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit; Rolin e Operacionit Monitorues Ndërkombëtar, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut në procesin e rivlerësimit.

## **2.3 Pritshmëritë nga zbatimi i projektligjit**

Pritshmëritë dhe dobishmëria e hartimit dhe miratimit të këtij projektligji del qartë nga qëllimi dhe objektivat e tij. Qëllimi i projektligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikën e Shqipërisë është :

**Garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.**

Objektivat konkrete që synohen të arrihen janë:

- a) Kryerja me efektivitet dhe sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, eficient, të besueshëm, të ndershëm, me integritet;
- b) Krijimi i një sistemi drejtesie profesional, bazuar në rritjen e cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- c) Ndërtimi i një sistemi të pavarur dhe të paanshëm, jashtë ndikimit të politikës dhe që funksion në bazë të disa parimeve dhe rregullave të mirëpërcaktuara dhe transparencës;
- d) Krijimi i një sistemi drejtësie sa më të mbrojtur nga ndikimi i krimit të organizuar dhe i politikës;
- e) Parandalimi i ndikimit të praktikave korruptive dhe elementëve të tjerë korruptivë në dhënien e drejtësisë dhe respektimi i parimit të barazisë para ligjit.

### **III. KONSULTIMI PUBLIK - PARIM UDHEHEQËS NË INICIMIN DHE HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Duke vlerësuar rëndësinë e reformës në drejtësi si një reformë në dobi të zhvillimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve, të zhvillimit ekonomik dhe mirëqënies së vendit, iniciimi i këtij procesi dhe zhvillimi i tij jashtë korpusit ekzekutiv qeverisës, në organin përfaqësues të popullit, në Kuvend, ishte pjesë e vizionit për procesin e kësaj reforme. Prosesi i reformës në sistemin e drejtësisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të respektojë parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, profesionalizmit, pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe konsultimit të gjerë midis gjithë aktorëve në këtë proces.

#### **3.1 Gjithëpërfshirja**

Projektligji u hartua nga ekspertët e nivelit të lartë, vendas dhe ndërkombëtar pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Grupi i punës për hartimin e këtij Ligji, filloi punën në nëntor të vitit 2015. Dokument bazë i punës së grupit ka qenë projekti i hartuar nga ekspertët e EURALIUS dhe OPDAT. Projekti i parë i hartuar nga ekspertët ndërkombëtar është paraqitur përpara grupit të punës të përbërë, nga përfaqësues të institucioneve, ekspertë të opozitës dhe ekspertë Think Tank. Ata kanë dhënë ndihmesën e tyre aktive për plotësimin dhe përmirësimin e projektit.

#### **3.2 Transparenca dhe konsultimi publik**

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi që përfaqëson institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë dhe misionet ndërkombëtare të Asistencës që operojnë në këtë fushë, ka zhvilluar debate dhe diskutime proaktive, duke mundësuar një proces konsultimi të gjerë të projektligjit. Idetë dhe struktura bazë për hartimin e këtij projektligji janë diskutuar së bashku me projektligjin për disa shtesat dhe ndryshimet në Kushtetutën e RSH gjatë tryezave të konsultimit publik të zhvilluara gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2015 dhe reflekton të gjitha ndryshimet dhe vendimmarrjet politike të marra në kuadër të diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve kushtetuese.

**Përmbajtja e këtij projektligji, në veçanti nga ligjet e tjera, është monitoruar drejtpërdrejt nga Komisioni Evropian (përfaqësues të DG NEAR dhe DG Justice). Për këtë arsye, përfaqësues të Misionit Euralius kanë zhvilluar seanca të përbashkëta pune me përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe veçanërisht përsa i takon pjesës që lidhet me Misionin Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe angazhimin e tij në faza të ndryshme të procesit të rivlerësimit.**

Aspekte të caktuara të ligjit, janë konsultuar në mënyrë të vazhdueshme edhe me ekspertët e Komisionit të Venecias. Ky konsultim ka nisur që në hartimin e draftit të parë të ligjit dhe më tej ka vazhduar me diskutime gjatë qëndrimit të tyre në Tiranë, në Nëntor 2015, Janar 2016 dhe gjatë seancave të mbledhjeve të Komisionit të Venecias në mars 2016.

Një ekspert nga Komisioni Evropian, Z. Priebe që vizitoi Shqipërinë në muajin qershor të këtij viti, ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të shkrimit të projektligjit.

Një ndihmesë të rëndësishme në përmirësimin e këtij projektligji kanë dhënë edhe tryezat e konsultimit të zhvilluara në muajt qershor – korrik 2016. Mbi bazen e kontributeve të prezantuara në to nga gjyqtarë, prokurorë e pedagogë të së drejtës janë përmirësuar disa dispozita lidhur me procesin dhe metodologjinë e rivlerësimit.

#### **IV. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PARIMIN E KUSHTETUTSHMËRISË, QASJA ME AKTET NDËRKOMBËTARE, SI DHE ME PROGRAMIN E DOKUMENTET POLITIKE TË REFORMËS NË DREJTËSI**

Sikurse është theksuar edhe më lart, projektligji u hartua në bazë e për zbatim të ndryshimeve kushtetuese, të miratuar në korrik 2016, konkretisht, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe të pjesës së Aneksit “*Rivlerësimi Kalimtar i Gjyqtarëve dhe i Prokurorëve*”. Projektligji respekton parimin e Kushtetutshmërisë dhe standardet që vendosin aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë fushë.

Ai reflekton rekomandimet e opinioneve të Komisionit të Venecias për këtë çështje, të pasqyruara në Aneksin e Amendamenteve kushtetuese. Paketa Kushtetuese mbi bazë dhe për zbatim të së cilës hartohet ky projektligj, iu dërgua për një mendim të specializuar Komisionit të Venecias, i cili u shpreh me opinionin e ndërmjetëm CDL-AL (2015)045 dhe opinion final CDL-AD (2016) 009. Konkretisht, në lidhje me masat e marra për procesin e rivlerësimit, Komisioni i Venecias është shprehur se: “*..është i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikuar, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi.*”

Projektligji është në përputhje të plotë me “Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë” dhe me “Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, të cilat janë miratuar nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Në këto dokumente janë parashtruar përfundime, objektiva dhe detyra për konsolidimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë.

Projektligji është harmonizuar me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe referohet pajtueshëm në disa ligje që rregullojnë çështje në fusha të ngjashme. Ai është harmonizuar edhe me projektligje të tjera që po hartohen dhe do të miratohen në mbështetje dhe në zbatim të kësaj pakete kushtetuese.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar i kushtoi kohën dhe vëmendjen e duhur diskutimit të projektligjit. Projektligji u prezantua së bashku me gjashtë projektligjet e tjera prioritare si pjesë e paketës ligjore që shoqëronte ndryshimet kushtetuese, në mbledhjen e datës 20 Qershor 2016<sup>1</sup>.

Projektligji u shqyrtua në parim, anëtarët e komisionit adresuan pyetje dhe morën përgjigje nga ekspertët në mbledhjen e datës 06.07.2016, në të cilën projektligji u miratua në parim nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar.

Fillimi i shqyrtimit të parë nen për nen të projektligjit u bë më datë 15.07.2016. Komisioni vendosi që për çështje të tilla si : formula e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit të pavaruar të kualifikimit, të Kolegjit të Apelimit dhe të Komisionerëve publike etj, për të cilat nuk kishte ende një konsensus politik, dhe që sipas Komisionit të Venecias ishin çështje për vendimarrje politike, në mungesë të pjesëmarrjes në këto mbledhje nga deputetët e opozitës, të lihen të hapura për një diskutim të mëvonshëm, bazuar edhe në miratimin final të ndryshimeve kushtetuese.

Miratimi i ligjit 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”” përfshirë Aneksin “Rivlerësim Kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” si pjesë e tij, mundësoi vazhdimin e diskutimit të projektligjit, duke mbajtur parasysh nenet tashmë të dakortësuara mbi bazën e konsensusit të arritur.

Në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, të mbajtur më datë 02.08.2016, anëtarët e opozitës në komision, paraqitën Opinionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mbi projektligjin. Ky opinion iu shpërnda anëtarëve të komisionit dhe ekspertëve të EURALIUS dhe OPDAT.

Në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, të datës 17.08.2016, ekspertët e EURALIUS/OPDAT paraqitën vlerësimet e tyre rreth komenteve të bëra në opinionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Në dokumentin zyrtar të prezantuar në komision ata konsideruan të pranueshme për reflektim në projektligj një sërë propozimesh nga ky opinion si dhe përcaktuan qartë propozimet që i konsideronin të papranueshme për shkak se binin ndesh me parashikimet e reja kushtetuese, me opinionin e Komisionit të Venecias dhe me Standartet e Bashkimit Europian mbështetur edhe në konsultimin përkatës me zyrat përgjegjëse në Bruksel.

Në mbledhjen e datës 23.08.2016, Komisioni realizoi shqyrtimin përfundimtar nen për nen të projektligjit duke reflektuar një sërë ndryshimesh konkrete në përmbajtjen e tij bazuar edhe në amendamentet konkrete të propozuara nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në këtë mbledhje komisioni.

Në përfundim Komisioni me shumicë të votave votoi në tërësi projektligjin. Deputetët e opozitës të pranishëm në mbledhje nuk morën pjesë në procesin e votimit në tërësi të projektligjit.

---

<sup>1</sup> Projektligji së bashku me ligjet e tjera ishte menduar të kalonin si paketë së bashku me projektligjin Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.

## V. PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT DHE ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Projektligji përbëhet nga 9 krerë dhe 71 nene dhe 4 shtojca, pjesë e këtij ligji. Sikurse u theksua më lart, projekti iu nënshtrua diskutimeve dhe konsultimeve në mbledhjet e komisionit. Varianti integral i projektligjit që i bashkëngjitet këtij raporti reflekton: a) çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit gjatë diskutimit në parim dhe nen për nen të projektligjit; b) çështje të ngritura në opinionin me shkrim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike; c) vlerësimet dhe riformulimet e misionit EURALIUS dhe OPDAT në përgjigje të çështjeve të ngritura gjatë debatit në komision, përfshi edhe një pjesë të konsiderueshme nga propozimet e bëra në opinionin e deputetëve të opozitës dhe amendamenteve të prezantuara në mbledhjen e komisionit.

### 5.1 Çështje të trajtuara në komision

Anëtarët e maxhorancës në komision parashtruan një sërë pyetjesh dhe çështjesh për diskutim gjatë seancës së diskutimit në parim dhe nen për nen të projektligjit.

Me ardhjen në komision, anëtarët e opozitës, në opinionin e tyre depozituar me shkrim, më datë 2 Gusht 2016, lidhur me përmbajtjen e projektligjit ndër të tjera nënvizonin :

- Përcaktimi i detajuar i rregullave dhe rasteve të mbarimit të mandatit të anëtarëve të Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelit, statusit të punonjësve të tyre, si dhe garancitë që mundësojnë shmangien e korrupsionit dhe abuzimit me detyrën prej tyre.
- Mënyra e përzgjedhjes së momentit të realizimit të procesit të rivlerësimit për subjekte të caktuara duhet të jetë sipas një kalendari të paracaktuar, me afate të mirëpërcaktuara, faza dhe procese të njohura, duke respektuar një rradhë preferenciale në varësi të rëndësisë së funksionit që ushtron subjekti.
- Projektligji duhet të përshkruajë në detaje garancitë për proces të rregullt ligjor për të gjitha subjektet e rivlerësimit.
- Teksti i projektligjit nuk detajon procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të vetting-ut, si dhe procesin e vlerësimit të kandidaturave, duke e lënë kështu këtë proces në diskrecionin e organeve të përfshira në procedurë, në kundërshtim me delegimin që ka bërë pika 12 e nenit C të Aneksit të Amendamenteve Kushtetuese. Nga ana tjetër, projektligji nuk detajon rastet e përjashtimit të kandidatëve nga konkurimi, mënyrën dhe arsyet e këtij përjashtimi, si dhe të drejtën e ankimit për përjashtimin.
- Roli i ONM dhe vëzhguesve ndërkombëtar të jetë në përputhje me nenin B dhe pikën 7 të nenit C të Amendamenteve Kushtetuese, që i koncepton ata si rojtarë që sigurojnë në veçanti transparencë, ndërsa kompetencën vendimmarrëse të jetë vetëm në duart e organit të brendshëm.
- Masa e jashtëzakonshme e rivlerësimit duhet të zbatohet ekskluzivisht nga organet e posacme të vettingut, pa asnjë rol aktiv të organeve ekzistuese, të kontrolluara apo nën varësinë e Kryeministrit.
- Procesi dhe standardet e kontrollit të figurës duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e Opinioneve të Komisionit të Venecias, Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si

dhe nenin DH të Aneksit të Amendamenteve Kushtetuese. Ky kontroll duhet të vë theksin tek objektiviteti, si dhe pasoja ose ndikimi që ka patur kontakti tek ushtrimi i rregullt i detyrës.

- Procesi i rivlerësimit duhet të përmbushë standardet për një proces të rregullt ligjor, duke mbajtur në konsideratë konstatimet e Komisionit të Venecias.  
Paragrafi 105 dhe 106 i Opinioneve të Ndërmjetëm: *“Të Drejtat dhe Liritë Personale të parashikuar nga Kushtetuta, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me privatësinë, barrën e provës, paprekshmërinë e banesës, etj., duhet të zbatohen edhe mbi gjyqtarët/prokurorët. Kufizimet në këtë rast nuk duhet të tejkalojnë kufizimet e lejuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke qenë se Shqipëria është e detyruar nga KEDNj dhe nuk mund të shmangë mbikqyrjen nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.”.*
- Disa dispozita të projektligjit janë konfuze, të paqarta, evazive, dhe përdorin një terminologji të pasaktë dhe shprehje të huaja, që humbasin kuptimin e qëllimit të normës.
- Duhet të sigurohet transparenca e plotë për publikun, në cdo fazë dhe në veprimtarinë e organeve në këtë proces.
- Koncepti i “provës” duhet të përmbushë standardin e besueshmërisë dhe objektivitetit që duhet të ofrojnë të dhënat dhe faktet për t’u konsideruar të tilla, si dhe të garantojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.
- Detajimi i kriterit kushtetues të “ndalimit të mbajtjes së funksioneve politike në administratën publike apo pozicione drejtuese në partitë politike”, duhet të zgjerohet duke përfshijë domosdoshmërisht funksionarët politik si ministër, zëvendësministër, deputet, etj. (që nuk janë organe drejtuese të partive politike), si dhe të saktohet rrethi i subjekteve të tjera që përfshihen nën këtë koncept, në përputhje me qëllimin e parashikimit të Amendamenteve Kushtetuese.

Një pjesë e çështjeve të mësipërme ishin diskutuar edhe më parë në komision dhe ekspertët vendas dhe ndërkombëtar kishin dhënë vlerësimet dhe qëndrimet e tyre për to duke marrë në konsideratë e reflektuar në tekstin e projektligjit një pjesë të konsiderueshme prej tyre.

Në mbledhjet e datave 17 dhe 23 gusht 2016, ekspertët e EURALIUS dhe OPDAT paraqitën para komisionit qëndrimet e tyre të konsultuara edhe me Komisionin Evropian për çështjen e ngritura si dhe sollën riformulime të neneve të veçanta të projektligjit lidhur më çështjet e diskutuara në mbledhjet e mëparshme. Gjithashtu, komisioni mori në konsideratë një pjesë të konsiderueshme të amendamenteve të sjella nga opozita me shkrim si dhe propozime të bëra gjatë debatit të anëtarëve në mbledhjet e Komisionit të cilat janë reflektuar gjerësisht në përmbajtjen e projektligjit të paraqitur për miratim në seancë plenare.

## **5.2 Objekti, qëllimi dhe parimet bazë të procesit të rivlerësimit**

Projektligji përcakton qartë objektin dhe qëllimet e tij. Neni 1 dhe 2 i projektligjit, i riformuluar përcakton si qëllim të ligji përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Dispozitat e riformuluara në komision janë sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së RSH.



Ligji përcakton parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët; metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit; organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit; si dhe rolin e Operacionit Monitorues Ndërkombëtar, i organeve të tjera shtetërore dhe i publikut në procesin e rivlerësimit. Parimet e rivlerësimit kalimtar janë të parashikuara në Kushtetutë (neni 179/b, & 2, në aneksin e saj (neni A, C, F) dhe në ligj (neni 4)

Projektligji përmban një nen që sqaron terminologji dhe/ose koncepte që përdoren në përmbajtjen e tij. Një pjesë e tyre janë riformuluar nga ekspertët dhe komisioni bazuar në sugjerimet e anëtarëve të komisionit, përfshirë edhe ato nga amendamentet e propozuara nga opozita.. Përkufizimet janë në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe Aneksin e saj lidhur me kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes, ndalesat për të ushtruar funksionin si dhe me ligje të tjera, si: me ligjin “Për nënpunësin civil” lidhur me konceptin “Funksione politike në administratën publike”; me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë, lidhur me konceptet “person i lidhur” dhe “persona të tjerë të lidhur”; me ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” lidhur me konceptim “pasuri të ligjshme”, me ligjin “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, lidhur me konceptin “person i përfshirë në krim të organizuar ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, për konceptin “ trust ” me ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative në RSH.

### **5.3 Subjektet e rivlerësimit, radha dhe afatet e rivlerësimit**

Subjektet e rivlerësimit janë të përcaktuara në Kushtetutë (neni 179/b. & 3 dhe 4). Ligji përcakton se rivlerësimi fillon menjëherë, duke plotësuar deklaratën e re të detajuar të pasurisë sipas formularit model të bashkëngjitur projektligjit.

Propozimet e opozitës lidhur me mosfillimin njeherësh të rivlerësimit, nevoja e përcaktimit të një kalendari, parashikimi i kufizimeve lidhur me kohën e bërjes së kërkesës për rivlerësim të ish gjyqtarëve dhe prokurorëve; parashikimi i zbatimit të kriterëve lidhur me zbatimin e kërkesave të në ligjin për 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” vetëm për personat që duan të rifuten në sistem dhe jo për ata që janë në sistem, kufizimi i afatit të ushtrimit të funksioneve politike për disa kategori funksionarësh si kriter ndalues nga 10 vjet që e parashikon Kushtetuta në 4 vjet, binin ndesh me parashikimet e reja Kushtetuese dhe kryesisht me aneksin e saj si dhe çënojnë parimin e barazisë para ligjit dhe të ligjshmërisë.

Ekspertët e misionit EURALIUS, në opinion e tyre të paraqitur me shkrim dhe në mbledhjen e komisionit të datës 17 Gusht 2016 theksuan se : *Nuk mund të ekzistojë një afat kohor ose një kalendar për secilin rast individual. Në procesin administrativ të rivlerësimit nuk aplikohet kodi i procedurës penale, çdo rast individual vendoset sa më shpejt të jetë e mundur. Të gjitha çështjet fillojnë menjëherë. Kjo pasi barra e provës mund të kalojë tek subjekti që vlerësohet, dhe procesi i rregullt kërkon kohë të mjaftueshme për hetime dhe mbledhjen e provave.*

## 5.4 Institucionet e rivlerësimit, kriteret dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve

Kreu II dhe III i projektligjit rregullojnë mënyrën e krijimit të organeve përgjegjëse në procesin e rivlerësimit. Në qasje me parashikimet në Aneksin e Kushtetutës, përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të organeve bëhet nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente, e cila fillon nga Presidenti i Republikës. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me dispozitat kushtetuese (Neni C i Aneksit) duke parashikuar kriteret dhe procedurë të detajuar, e cila kalon në disa faza dhe realizohet nga disa struktura të ngritura me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, duke u monitoruar nga Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit (nenet B dhe C të Aneksit).

Kushtetuta përcakton kompetencat dhe marrëdhëniet mes institucioneve që përzgjedhin anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, por jo detajim të tyre. Anëtarët e komisionit dhe opozita në opinionin e saj me shkrim, sugjeron përcaktimin e disa afateve dhe detajimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Ekspertët e EURALIUS u shprehën dakord për nevojën e detajimit të disa procedurave dhe të afateve.

Projektligji i rishikuar parashikon rregulla të detajuara për paraqitjen dhe shqyrtimin e aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit nga Presidenti i Republikës (neni 7), dhe shton disa nene të reja që parashikojnë afatet e ngritjes së komisionit *ad hoc* parlamentar për verifikimin e kandidatëve, të komisioneve *ad hoc* parlamentar për përzgjedhjen e kandidatëve, të procesit të votimit të kandidatëve nga komisionet *ad hoc* të përzgjedhjes dhe votimi i kandidatëve në seancë plenare. Projektligji i rishikuar parashikon garancitë që duhet të ketë procesi i votimit të fshehtë elektronik i parashikuar në Kushtetutë.

Përsa i përket organizimit dhe funksionimit të organeve, projektligji rregullon organet e rivlerësimit: Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (Komisioni) dhe Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit (Kolegji i Apelimit). Komisionerët Publikë kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesave të publikut në të gjithë procesin, si dhe parimin e kontradiktoritetit në të.

Në vijim të rregullimeve kushtetuese, projektligji ka parashikuar se Komisioni do të shqyrtojë në trupa gjyqësorë të përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Trupi gjyqësor do të drejtohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tij. Kryetari i trupit gjyqësor kryen drejtimin e mbledhjes, caktimin e shortit dhe koordinimin e punës në tërësi. Për çdo çështje që shqyrtohet zgjidhet një relator, i cili është pjesë e trupit gjyqësor. Ai përgatit dosjen për subjektin e rivlerësimit sipas secilit komponent, heton për çështjen duke mbledhur provat e nevojshme dhe në përfundim, përgatit një relacion duke propozuar masa konkrete disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

Kolegji i Apelimit është organi që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Komisionit. Ai vendoset pranë Gjykatës Kushtetuese të RSh, i përbërë nga 7 gjyqtarë dhe gjykon me trupa gjyqësorë të përbërë nga 5 anëtarë. Në zbatim të dispozitave kushtetuese, Kolegji i Apelimit do të shërbejë për një periudhë 9 vjeçare dhe do të kryejë edhe detyrën e organit disiplinor për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ky Kolegj do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Anëtarët e institucioneve gjatë ushtrimit të detyrës udhëhiqen nga parimi i paanshmërisë, dhe konfidencialitetit. Ata shmangin çdo situatë konflikti interesi gjatë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, anëtarët e institucioneve dhe personeli, janë subjekt i deklarimit të pasurive sipas ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë". Telekomunikimet dhe të dhënat e tyre financiare do të jenë subjekt i monitorimit nga autoritetet përgjegjëse sipas procedurave të posaçme që parashikon ky ligj. Anëtarëve të institucioneve, familjarëve të tyre, personelit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, projektligji iu garanton edhe një mbrojtje të posaçme sipas legjislacionit në fuqi.

Në këtë kre parashikohet përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të institucioneve si një element i rëndësishëm në llogaridhënien e tyre. Rastet e shkarkimit të anëtarëve janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm për fillimin e procedurës disiplinore për anëtarët e institucioneve, hetimi disiplinor mund të fillojë nga çdo komisioner, për anëtarët e komisionit, nga çdo gjyqtar për gjyqtarët dhe nga çdo vëzhgues, si për komisionerët, edhe për gjyqtarët.

Projektligji ka parashikuar se trupi gjykues do të ndihmohet nga Njësia e Shërbimit Ligjor, që konsiston në këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë. Ai cakton shprehimisht detyrat, procedurat e rekrutimit dhe mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve të punësimit. Në personel bën pjesë edhe një punonjës, si person i autorizuar për të komunikuar me publikun dhe median. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në administrimin e personelit të institucioneve, do të ketë Sekretari i Përgjithshëm që përzgjidhet nga radhët e juristeve me një nivel të lartë profesionalizmi dhe integriteti, nëpërmjet një procedure të hapur, transparente dhe të bazuar në meritokraci.

Institucionet e rivlerësimit propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre në Komisionin që mbulon çështjen ligjore pranë Kuvendit, e paraqet për miratim në Kuvend, si pjesë integrale të Buxhetit të Shtetit. Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta. Institucionet e rivlerësimit zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre, të miratuar nga Kuvendi, si dhe kanë të drejtë të përdorin të ardhurat dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare, donacionet dhe botimet e tyre.

Kontrolli financiar i institucioneve të rivlerësimit kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

### **5.5. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe Roli i tij në Procesin e Rivlerësimit**

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të monitorohet dhe mbikqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM). Roli i tij përcaktohet në Kushtetutë (neni B i Aneksit). Ky operacion përfshirë partnerët në kuadër të integritetit Europian dhe bashkëpunimit euroatlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Europian. Përzgjedhja e vëzhguesve dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kushtetutë. Projektligji parashikon bashkëpunimin e ONM-së me institucionet që marrin pjesë në përzgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit dhe në procesin e rivlerësimit.

Në Opininionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të paraqitur në komision thuhej se : *...mund të ketë nevojë për detajimin e detyrave të misionit me rregulla në këtë ligj për shkak se ONM nuk mban përgjegjësi në rastet e mosveprimit ose të shkeljes së normave juridike*

*shqiptare. ... Ligji duhet të përcaktojë si veprojnë autoritetet shqiptare në procedurën e rivlerësimit, për kompetencat që ushtron ONM.*

Në mbledhjen e komisionit, ekspertë të EURALIUS theksuan qëndrimin e BE-se : *Roli i misionit ndërkombëtar monitorues nuk mund të reduktohet. Monitorimi i projektuar ndërkombëtar është një instrument i rëndësishëm për t'i mundësuar publikut të rifitojë besimin në gjyqësor.*

Në zbatim të parashikimeve kushtetuese, projektligji ka parashikuar se Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të ketë rol monitorues dhe rekomandues në formimin e institucioneve të reja që do të merren me procesin e vlerësimit. Vetingu për të zgjedhurit e rinj në këto institucione do të kryhet përmes përfshirjes aktive në këtë fazë të procesit të ONM, duke realizuar kështu kontrollin mbi kontrollorët e vet sistemit me qëllimin që askush të mos mbetet pa ju nënshtruar vetingut dhe për më tepër ata që do të kenë barrë e gjithë këtij procesi të vështirë dhe delikatë. Opinioni i specializuar i Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit do të shërbejë për përgatitjen e listave finale mbi të cilat do të votohet nga ana e komisioneve ad-hoc që do ngrëjë kuvendi me anëtarët e vet sipas parashikimeve në kushtetutë dhe në ligj.

## **5.6 Vlerësimi i pasurisë**

Kushtetuta e RSH përcakton se rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH, E të Ankesit dhe të ligjit (neni Ç i Aneksit). Vlerësimi i pasurisë regullohet në mënyrë më të detajuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

Kreu IV i projektligjit parashikon rregullat mbi bazën e të cilëve do të kryhet vlerësimi pasuror. Objekti i vlerësimit pasuror përfshin deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Vlerësimi sipas këtij komponenti pasuror do të fillojë menjëherë më hyrjen në fuqi të këtij ligji. Prandaj, të gjithë subjektet e rivlerësimit duhet të dorëzojnë brenda 30 ditëve pranë ILDKPKI formularin e deklarinimit të pasurive, sipas parashikimeve në aneksin e këtij projektligji.

Të gjithë subjektet e rivlerësimit janë të detyruar që krahas formularit të deklarinimit të pasurive, të dorëzojnë të gjithë dokumentet që provojnë ligjshmërinë e pasurive të tyre. Këtë detyrim e mbartin edhe personat e lidhur me subjektet e rivlerësimit, në rast se konfirmojnë marrëdhënien me to.

Autoriteti përgjegjës për përpunimin e të dhënave të formularëve të deklarinimit të pasurive do të jetë ILDKPKI, i cili do të nisë pa vonese kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti, në përputhje me ligjin e posaçëm dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij procesi, nga ILDKPKI duhet të përpilohet një raport në të cilin konstatohet saktësia apo pavërtetësia e deklarinimit, si dhe nëse ndodhemi në situatën e konfliktit të interesit.

Në mbledhjet e Komisionit dhe në Opinionin me shkrim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, theksohej se *...projektligji i jep peshë kryesore në procesin e rivlerësimit institucioneve të tilla si ILDKPKI, DSIK, SHISH, SHCBA pranë MB, si dhe Inspektorateve pranë KLD dhe Prokurorisë, si dhe Shkolla e Magjistraturës. ....Në mënyrën se si është konceptuar*

*projektligji, prova në procesin e rivlerësimit merret dhe formohet pranë këtyre institucioneve, të cilat nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor dhe në këtë mënyrë zhveshin nga kompetenca kushtetuese institucionet e vërteta të procesit të rivlerësimit, që janë Komisionerët, Komisioni i Rivlerësimit dhe Kolegji i Apelimit.*

Anëtarët e maxhorancës në Komision u shprehën se projektligji është në përputhje me parashikimet kushtetuese, konkretisht me nenin D të Aneksit, & 2 i cili përcakton se .... *ILDKPKI kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit një raport për ligjshëminë e pasurive, për saktësinë dhe plotësimin e deklaramit sipas ligjit.*

Lidhur më këtë çështje, ekspertët e misionit EURALIUS u shprehën se : *“Procesi i ri-vlerësimit përdor informacionin, dosjet dhe strukturat administrative ekzistuese, në mënyrë të veçantë ILDKPKI-në për kontrollin e pasurisë dhe autoritetet policore dhe të inteligjencës për vlerësimin e figurës. Njohuritë dhe kompetenca e tyre është e nevojshme dhe nuk mund të zëvendësohet nga stafi i ri ose strukturat e reja. Roli i ILDKPKI-së është parashikuar në Kushtetutë dhe nuk mund të vihet në pikëpyetje. Roli i saj është që të japë të gjithë informacionin që ata kanë, por jo konkluzione, të cilat janë për organet e ri-vlerësimit. Zbatimi i ri-vlerësimit, hetimi dhe vendimi përfundimtar bëhet gjithmonë nga institucionet e ri-vlerësimit nën monitorimin ndërkombëtar.”*

## **5.7. Vlerësimi i figurës**

Vlerësimi i figurës rregullohet në mënyrë më të detajuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Kreu V i projektligjit sanksionon rregullat mbi bazën e të cilave do të kryhet kontrolli i figurës. Ky kontroll do të konsistojë në verifikimin e deklarimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim identifikimin e kontakteve të papërshtatshme nëse ekzistojnë, midis subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar për periudhën e parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me kriteret e detajuara të vlerësimit të figurës, anëtarët e Komisionit parashtruan pyetje për ekspertët hartues të projektligjit. Anëtarët e komisionit, por dhe në Opinionin me shkrim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, theksohej nevoja ....e qartësisht *dhe sqarimit më të mirë të faktit nëse telefonata ose telekomunikimi, duhet të ketë qenë e qëllimshme dhe që cenonte ushtrimin e detyrës, apo do të mjaftonte edhe një telefonatë rastësore dhe telekomunikim rastësor, që nuk ka cenuar ushtrimin e rregullt të detyrës nga subjekti i rivlerësuar. Gjithashtu, nocioni “kontaktit të papërshtatshëm” u kërkua të sqarohet dhe rishikohet duke vënë theksin te momenti i dijenisë së subjektit, mbi natyrën e kontaktit dhe cilësitë e personit që po kontaktohet.*

Projektligji i bashkëngjitur këtij raporti reflekton diskutimet dhe sugjerimet e anëtarëve të komisionit. Gjithashtu roli i institucioneve të rivlerësimit dhe bashkëpunimi i institucioneve të tjera me to është theksuar qartë dhe saktë.

Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) janë autoritetet përgjegjës për përpunimin e të dhënave të formularit për kontrollin e figurës. Ky ligj parashikon krijimin e një grupi pune të përbërë edhe nga përfaqësues të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Brendshme. Projektligji sanksionon në mënyrë të detajuar standardet mbi bazën e të cilit do të bëhet kontrolli të figurës, të cilat janë të njëjta me ato që aplikohen nga vendet anëtare të NATO-

s gjatë procesit të vlerësimit të sigurisë. Në përfundim të këtij procesi, grupi i punës duhet të përpilojë një raport/dokument në të cilin konstaton vërtetësinë ose jo të të dhënave, si dhe nëse subjekti ka pasur ose jo kontakte të papërshtatshme që tregojnë me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Ky raport i përcillet nga DSIK-ja Komisionit.

## **5.8 Vlerësimi i aftësive profesionale**

Vlerësimi i aftësisë profesionale rregullohet në mënyrë më të detajuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Kreu VI i projektligjit sanksionon rregullat mbi bazën e të cilave do të kryhet vlerësimi i aftësive profesionale. Për këtë do të kryhet vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë projektligj dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Projektligji ka parashikuar në mënyrë specifike burimet e rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kategorive të caktuara të subjekteve të rivlerësimit duke u referuar në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale kryen vlerësimin e dokumenteve ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit dhe bazuar në gjetjet, ata përgatisin një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Në bazë të informacioneve që disponohen, vlerësimi shtrihet nga 1 Janar 2006. Ky raport i paraqitet menjëherë Komisionit. Ndërsa, për Prokurorin e Përgjithshëm, si burim vlerësimi do të shërbejë performanca për një periudhë 3 vjecare nga fillimi i mandatit në përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë.

Në projektligj një element i rëndësishëm i vlerësimit profesional është dhe vlerësimi i këshilltarëve të GjL, GJK, PP, dhe Gjykatave administrative, të cilët nuk janë magjistratë të cilët i nënshtrohen testimit në Shkollën e Magjistraturës. Projektligji për subjektet e rivlerësimit të cilët kërkojnë rivlerësimin me kërkesën e tyre parashikon gjithashtu testimin në Shkollën e Magjistraturës.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale organet e vlerësimit profesional hartojnë një raport që ia drejtojnë Komisionit. Mbështetur në këtë raport dhe nga burimet e tjera, relatori i çështjes pranë Komisionit konstaton nëse subjekti i rivlerësimit është: i aftë, me mangësi, ose i papërshtatshëm.

## **5.9 Procedura e rivlerësimit**

Procedura e rivlerësimit rregullohet nga neni Ç, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës. Kreu VII i projektligjit rregullon me në detaje procedurën e rivlerësimit. Prosesi i rivlerësimit është një procedure disiplinore e procesit gjyqësor administrativ. Konkretisht referuar neneve E dhe F të Aneksit Kushtetues, të cilat gjejnë zbatim në këtë kapitull, procesi i rivlerësimit kalon në dy shkallë gjykimi. Shkalla e parë e shqyrtimit është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse shkalla e dytë është Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Në këtë proces, rregullohet ushtrimi i veprimtarisë së vëzhguesit ndërkombëtar, si një strukturë që ndihmon këto institucione në arritjen e një vendimmarrjeje të drejtë dhe të paanshme ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, anëtarët e Komisionit, të Kolegjit të Apelimit dhe

vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejta të barabarta gjatë fazës së hetimit administrativ për të mbledhur dhe administruar prova, që vërtetojnë veprimet, faktet, ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Për këtë qëllim atyre iu është dhënë e drejta për akses të plotë në të gjitha institucionet private dhe publike, vendase ose të huaja, për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit.

Në rastin kur institucioni shtetëror/privat brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për dhënien e informacionit refuzon për të bashkëpunuar, ose vonon dhënien e përgjigjes apo shfaq sjellje të papërshtatshme për të dhënë informacionin e kërkuar, institucionet kanë të drejtë ta raportojnë pranë zyrës së prokurorisë si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

Në procesin e të provuarit i është kushtuar rregullim denoncimit të fakteve nga publiku që mund të përbëjnë prova për një nga komponentët e rivlerësimit. Çdo person ka të drejtë të sinjalizojë institucionet për fakte apo prova konkrete me kusht që t'i ruhet anonimat. Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse konstatojnë që veprimi apo praktika e raportuar përmban shkaqe, mund të fillojnë hetimin *kryesisht* për të.

Në tërësinë e provave, gjetja e dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën një provë, refuzimi i të cilës i detyron organet të japin një vendim me shkrim mbi shkaqet e refuzimit.

Projektligji parashikon afate për zhvillimin e procesit të rivlerësimit në përputhje me kushtet sociale në interes të subjekteve të rivlerësimit. Afatet kohore për dorëzimin e formularit të deklaramentit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës janë caktuar të fillojnë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Strukturat përkatëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga dokumentet zyrtare duhet të procedojnë pa vonesë, për t'ia dërguar Komisionit, i cili është hallka e parë e shqyrtimit të tyre. Për sa i takon mënyrës se si subjektet e rivlerësimit do të njoftohen në vijimësi të procesit, është vendosur njoftimi nëpërmjet adresës elektronike si mënyra primare e njoftimit, ndërkohë nuk janë përjashtuar edhe mënyra të tjera alternative që parashikon Kodi i Procedurave Administrative.

Projektligji në përputhje me parashikimet kushtetuese ka përcaktuar se barrën e provës, e cila nënkupton detyrimin për të provuar ligjshmërinë e deklaramentit, e ka subjekti i rivlerësimit. Në disa raste, subjekti i rivlerësimit mund të ketë interes në vonimin e procedurave të rivlerësimit. Për të shmangur këto praktika të gabuara, ligji i lejon organet që në marrjen e vendimit të mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.

Subjektit të rivlerësimit, i jepet e drejta të dëgjohet lidhur me përfundimet e konstatuara nga relatori i çështjes. Për këtë zhvillohet seanca dëgjimore në prani të publikut. Në përfundim të saj, Komisioni jep vendimin për subjektin e rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në këtë rast, ndaj subjektit pushohet procedura e rivlerësimit dhe në përputhje me këtë projektligj i akordohet pension i veçantë. Sipas Nenit G të Aneksit të kushtetutës, subjektet e rivlerësimit që japin dorëheqje nuk kanë të drejtë të emërohen për një periudhë 15 vjeçare, në asnjë prej organeve të sistemit të drejtësisë, si prokuror ose gjyqtar në çdo nivel, anëtar i këshillit të lartë Gjyqësor ose Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

Nenet e këtij Kreu përcaktojnë në mënyrë të detajuar shkaqet për marrjen e masave disiplinore. Në çdo rast, Komisioni është i detyruar të arsyetojë vendimet e tij lidhur me shkaqet e dhënies/ose jo të masës disiplinore. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit për shkarkim nga puna, ai pezullohet nga detyra që do të thotë se ai nuk ka të drejtë të gjykojë çështje.

#### **5.10 Apelimi - si një e drejtë thelbësore për një proces të rregullt ligjor**

Kushtetuta e RSH (neni F i Aneksit) parashikon se ankimi kundër vendimeve të Komisionit të pavaruar të Kualifikimit bëhet në Kolegjin e Apelit sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë edhe ankim në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (neni F i Aneksit, paragrafi 1 dhe 8).

Kreu VIII i projektligjit parashikon rregulla mbi shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të Komisionit. Projektligji parashikon se mjetet dhe afatet e ankimit të këtyre vendimeve do të jenë të njëjta me ato që parashikohen në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit e kanë subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik. Afati brenda të cilit palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankim është 15 ditë nga marrja dijeni për vendimin. Por në rast se humbet ky afat për shkaqe të arsyeshme dhe legjitime, palët kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve nga dita që vihen në dijeni të shkakut të humbjes së të drejtës, por jo më vonë se afati i parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës.

Përsa u përket kërkesave që duhet të plotësojë ankimi dhe aktet që i bashkëlidhen, projektligji referon në dispozitat përkatëse të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Gjithashtu, këtu përcaktohen edhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit apo Komisionerit Publik në momentin e depozitimit të ankimit, si dhe veprimet të cilat ai është i detyruar të kryejë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Apelit shqyrton mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore në prani të palëve kur e sheh të nevojshme në përputhje me rregullimet e këtij ligji. Përrjashtim nga ky rregull përbën, kur ankimi është ushtruar nga Komisioneri Publik, në këtë rast trupi gjykues shqyrton në seancë gjyqësore/publike me praninë e palëve.

Përsa u përket rregullave për zhvillimin e seancës gjyqësore, projektligji referon në dispozitat përkatëse të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelit vendos lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, ndryshimin e vendimit të Komisionit ose prishjen e vendimit të Komisionit. Vendimi për shkarkimin nga detyra i dhënë nga Kolegji i Apelit është vendim i formës së prerë. Subjekti i rivlerësimit sipas nenit F të Aneksit të Kushtetutës gëzon të drejtën për t'iu drejtuar GJEDNJ.

KREU IX përmban përcaktime tranzitore, të cilat lidhen me marrëdhëniet kalimtare midis institucioneve si dhe detyrimi i nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.



Miratimi i këtij projektligji si pjesë e paketës kushtetuese dhe ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe zbatimi i suksesshëm i tij, hap rrugën për fillimin e zbatimit të reformës në drejtësi dhe kryesorja për fillimin e funksionimit të një sistemi drejtësie eficient, të pavarur, të paanshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Kjo reformë është një hap shumë i rëndësishëm edhe në procesin e integrimit të europian të vendit.

**RELATOR**

**Pandeli Majko**



**KRYETAR**

**Fatmir XHAFAJ**

